



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
 - * Aktivitetet për stafin administrative të gjykatave dhe prokurorive
- * Aktivitetet tjera

Shtator 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

Zbatimi i masave të fshehta hetimore

Më 05 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temën “Zbatimi i masave të fshehta hetimore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive rreth procedurës së zbatimit dhe aplikimit të këtyre masave në drejtim të sqarimit të dilemave që paraqiten në praktikën gjyqësore.

Gjatë këtij trajnimi u theksua rëndësia e këtyre masave dhe zbatimi i tyre i drejtë në praktikë, kushtet dhe afatet ligjore për lëshimin e këtyre masave, llojet e të gjitha masave dhe fazat e hetimit gjatë të cilave ato mund të autorizohen.

Më tej u trajtuan kushtet ligjore, personat e autorizuar për lëshimin e masave të fshehta, hartimi i urdhrave për zbatim të këtyre masave dhe përmbajtja e kërkesës për marrjen e këtyre urdhrave për autorizimin e masave.

Metodologjia për realizimin e trajnimit ishte kombinim i teorisë dhe rasteve praktike gjyqësore të parashtruara nga trajnuesit me qëllim të kontributit në standardizimin e praktikës së punës lidhur me këtë fushë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët të nivelit themelor si dhe zyrtar policor nga Policia e Kosovës.



Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj

Me 06 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temën “Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e legjislacionit lidhur me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve dhe pjesëtimin e saj, bazuar në praktikën gjyqësore.

Gjatë trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me nocionin dhe rolin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe vërtetimin e kontributit të bashkëshortëve. Më tutje në pjesën e dytë u trajtua administrimi i pasurisë së përbashkët dhe bashkëpronësisë dhe pjesëtimi i pasurisë së

përbashkët të bashkëshortëve.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, ku secili nga pjesëmarrësit ka qenë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, për të arritur në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Në trajnim kanë dominuar rastet lidhur me administrimin e pasurisë së përbashkët dhe pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët e gjykatave themelore nga departamenti i përgjithshëm, divizioni civil.



Neni 6 i KEDNJ si dhe zbatimi i tij

Me 08 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temën “Neni 6 i KEDNJ si dhe zbatimi i tij”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me zbatimin e drejt të kritereve dhe garancive që përmban neni 6 i KEDNJ.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me përmbajtjen e dispozitave të nenit 6 të KEDNJ, mbrojtjet procedurale sipas dispozitave të nenit 6 të KEDNJ, të drejtën e dëgjimit të drejtë dhe publik, të drejtën për t’u gjykuar pa vonesë të tepruar, të drejtën e të akuzuarit të pyesë ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të marrë pjesë dhe të ekzaminojë dëshmitarët nën emrin e tij.

Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan çështjet që lidhen me të drejtën e të akuzuarit për të marrë ndihmën falas të një përkthyesi në qoftë se nuk

e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në gjykatë, pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave në kontekst të nenit 6 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ lidhur me këtë nen.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorë metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore e GJEDNJ, ku secili nga pjesëmarrësit ka qenë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit. Në trajnim kanë dominuar rastet lidhur me zbatimin e drejt të kritereve dhe garancive që përmban neni 6 i KEDNJ.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga gjykata dhe prokurori të ndryshme të regjioneve të Kosovës.



Menaxhimi i Rasteve

Më 12 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temën “Menaxhimi i Rasteve”.

Qëllimi i trajnimit ishte që pjesëmarrësit të kuptojnë se sa i rëndësishëm është procesi i menaxhimit të drejtë të rasteve në institucionet e drejtësisë, si t’iu shmangen situatave jo të dëshirueshme gjatë punës së tyre, si ti minimizojë vonesat dhe të shfrytëzohet sa më mirë koha dhe burimet në dispozicion, si të rrisin efikasitetin e punës, krijojnë një ambient të mirë e kolegial dhe të rrisin nivelin e llogaridhënies në punë.

Trajnuesit përmes prezantimit si dhe diskutimit interaktiv me pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat, opinionet dhe dilemat në lidhje me zbatimin e teknikave për menaxhimin e rasteve, parimet themelore të menaxhimit të rasteve si dhe sfidat që paraqiten gjatë menaxhimit të rasteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelore, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor.



Veprat penale kundër detyrës zyrtare

Më 13 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temën “Veprat penale kundër detyrës zyrtare”.



Qëllimi i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve të pjesëmarrësve në trajtimin sa më me sukses të veprave penale që cenojnë sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik dhe perspektiven e vendit, që nga faza e hetimit nga prokuroria si dhe të gjykimit të tyre nga ana e gjykatës.

Në përmbajtjen e tij ky aktivitet trajnues ka përfshirë tema si: hetimi efektiv i veprave penale kundër detyrës zyrtare, tejkalimi i kufijve të kompetencës përkatësisht autorizimeve zyrtare, mos kryerja e detyrës zyrtare si dhe marrja dhe dhënia e ryshfetit.

Trajnimi u realizua përmes prezantimit, diskutimit interaktiv si dhe shembujve praktik ku pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat, opinionet ose dilemat në lidhje me trajtimin e këtyre veprave penale. Kjo metodë rezultoi të ishte shumë efikase, pasi që të gjithë pjesëmarrësit u përfshinë në debat konstruktiv dhe gjithëpërfshirës.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë të nivelit themelorë nga gjykata të regjioneve të ndryshme



Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës Sesioni II

Më 15-16 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e dytë të trajnimit me temën “Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës”.

Synimi i këtij trajnim ishte që të trajnojnë pjesëmarrësit të zhvillojnë njohuritë rreth fazës së implementimit të kontratës dhe hetimi dhe gjykimi i veprave penale të kësaj natyre.

Seanca e trajnimit u nda në dy pjesë, në ditën e parë të trajnimit u trajtua faza e implementimit të kontratës, vlerësimi i nevojave/përcaktimi i kërkesave, përgatitja/procesi i dizajnit dhe përgatitja dokumenteve të ofertimit, zgjedhja e kontraktorit dhe faza e dhënies së çmimit.

Ndërsa në ditën e dytë të trajnimit pjesëmarrësit u njoftuan me: skemat korruptive dhe problemet e ndërlidhura me mashtrim, si të bëhet planifikimi i hetimit dhe ndjekja. Me theks të veçantë u trajtuan edhe pagesa e haraçit, konflikti i interesit, skemat e kurdisjes së ofertave, ofertomi konspirativ, skemat mashtruese, përmbajtja e planit të hetimit, identifikimi i burimeve të informacionit, planifikimi i kontrollit të shtëpisë dhe përgjimi, planifikimi i përdorimit të informatorëve si dhe planifikimi i gjurmimit të aseteve.

Përfitues të këtij sesioni trajnues ishin gjyqtar dhe prokurorë të nivelit themelore nga regjionet të ndryshme të Kosovës.



Krimet e Urrejtjes

Më 18 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OSBE, ka realizuar trajnimin me temë “Krimet e Urrejtjes”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me kornizën ligjore të Kosovës dhe të drejtës ndërkombëtare lidhur me krimet e urrejtjes.

Gjatë këtij sesioni trajnues u trajtuan: instrumentet ndërkombëtare dhe dispozitat ligjore vendore lidhur me krimet e urrejtjes, teknikat për identifikimin, hetimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e krimeve nga urrejtja.

Në kuadër të këtij sesioni trajnues u trajtuan edhe rrethanat e përgjithshme rënduese, që përdoren për përcaktimin e dënimit ndaj kryerësit, të cilat gjenden në paragrafin 2.12 të nenit 74 të KPK-së e që mbulon veprat penale që konsiderohet se janë kryer me motiv paragjykimi.

Me theks të veçantë u theksua se nëse vepra

penale kryhet ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ose mungesës së besimeve fetare, ngjyrës, gjinisë, orientimeve seksuale, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura. Dispozita e rrethanës së përgjithshme rënduese siguron se të gjitha veprat penale që janë të përcaktuara me KPK-në, e të cilat kryhen me një motiv paragjykimi, i nënshtrohen dënimeve më të ashpra.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, duke vënë në pah kornizën ligjore të aplikueshme për krimet e urrejtjes dhe sfidat e vështirësitë në praktikë në rastet që ndërlidhen me këtë temë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, bashkëpunëtorë profesional dhe policë nga regjioni i Mitrovicës.



Kompensimi i dëmit jo material

Me 19 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Kompensimi i dëmit jo material”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me kompensimin e dëmit jo material.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan çështjet që lidhen me bazat e përgjegjësisë për dëmin jo material dhe kriteret për përcaktimin e dëmit jo material. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtua shpërblimi i dëmit jo material.

Gjate trajnimit janë trajtuar qartë institutet juridike në lëmin e përmendur dhe pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit ishin në gjendje që të interpretojnë drejt dispozitat lidhur me përgjegjësinë dhe format e

dëmit jo-material, të vlerësojnë kriteret për përcaktimin e dëmit jo-material, dhe të zbatojnë drejtë dispozitat për lartësinë për shpërblimin e dëmit jo-material.

Metodologjia e trajnimit ishte e kombinuar, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, ku secili nga pjesëmarrësit ka qenë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, për të arritur në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Në trajnim kanë dominuar rastet lidhur me bazat e përgjegjësisë për dëmin jo material dhe kriteret për përcaktimin e dëmit jo material.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e gjykatave themelore nga divizioni civil.



Kontratat në ekonomi

Më 20 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temën “Kontratat në ekonomi”.

Qëllimi i këtij trajnim ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me kontratën mbi ndërtimin dhe specifikat e tyre, kuptimin e klauzolave në kontratat e ndërtimit, kontratën publike, si dhe zbatimin e uzansave të ndërtimit në kontratat e ndërtimit.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan çështjet e lidhjes së kontratës, veprimet paraprake për lidhjen e kontratës për ndërtimin, vendimi për ndërtimin e objektit, sigurimi i mjeteve financiare, leja e ndërtimit, çmimi i punimeve, si dhe ndryshimi i çmimeve.

Po ashtu trajnimi u fokusua edhe në programin investiv dhe dokumentacioni teknik, ku programi investiv përmban përshkrimin e objektit dhe të dhënat mbi qëllimin e objektit dhe kohëzgjatjen e ndërtimit, si dhe afatet e kryerjes së punës që janë të caktuar në kontratë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësi të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikën gjyqësore aktuale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore si dhe zyrtarë ligjor nga Departamenti për çështje ekonomike.



Dënimet që u shqiptohen të miturve

Më 26 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në mbështetje të UNICEF organizoi trajnimin me temë “Dënimet që u shqiptohen të miturve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve dhe shkathhtësitë adekuate në zbatimin e dispozitave ligjore me rastin e shqiptimit të dënimeve për të mitur në frymën e konventave dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtën e të drejtave të fëmijës.

Trajnimi ishte bazuar në agjendë me ç ‘rast temat e prezantuara nga trajnuesit krijuan debat konstruktiv për pjesëmarrësit. Seanca e trajnimit u nda në dy pjesë dhe u prezantua nga trajnerët duke përfshirë: llojet e dënimeve të cilat mund tu shqiptohen të miturve, kushtet të cilat duhet plotësuar që të miturit t’i shqiptohet ndonjëra prej dënimeve, përcaktimi i

kohëzgjatjes së urdhrin për punë në dobi të përgjithshme; përcaktimi i kohëzgjatjes së burgut për të mitur.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore me rastin e shqiptimit të dënimeve për të mitur.

Përfitues te këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga departamenti për të mitur nga regionet e ndryshme të Kosovës.



Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve

Më 27 shtator 2017, Akademinë e Drejtësisë në mbështetje të UNICEF organizoi trajnimin me temë “Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte unifikimi i praktikave me rastin e ekzekutimit të masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturve.

Gjatë trajnimit trajnuesit u fokusuan në trajtimin e ekzekutimit të masave të diversitetit dhe masave edukative, ekzekutimi i gjobës dhe urdhrat për punë në dobi të përgjithshme, procedura e shqyrtimit, zëvendësimit dhe pushimit të masave edukative dhe ekzekutimi i burgut për të mitur.

Po ashtu gjatë trajnimit u theksua që të aplikohen sa më pak dënimet me burg për të mitur, për shkak të pasojave që mund të lë tek i mituri, u diskutuan edhe parimet udhëzuese të përcaktuara në KDM, siç është interesi më i mirë i të miturit, sigurimi i mirëqenies së tij, parimi i urgjencës, dhënia e ndihmës ligjore profesionale, prej fillimit të procedurës, etj.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga departamenti për të mitur të nivelit të apelit dhe nivelit themelor nga regionet e ndryshme të Kosovës.



Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës

Më 27 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me CRPK-në/Partner Implementues i UNHCR, ka realizuar trajnimin me temë “Lëvizja dhe qëndrimi i të huajve si dhe procedurat ligjore ndaj tyre në Republikën e Kosovës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me dispozitat ligjore në fuqi për azilin dhe zbatimin e tyre me rastin e vendosjes për azilin, njohja me procedurën e azilit që zhvillohet pranë Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit Kombëtar për Refugjatë të Kosovës si dhe procedura e konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjatë këtij trajnimi vëmendje e veçantë u përkushtua bashkëpunimit midis shteteve dhe UNHCR-it për zgjidhjen e problemeve të refugjatëve, posaçërisht kur ekziston lëvizja e papritur dhe masive e zhvendosjes së njerëzve përgjatë kufijve, me qëllim të harmonizimit dhe përmirësimit të ofrimit të mbrojtjes ndërkombëtare në rajonet përkatëse, si dhe

përkufizimet e refugjatit në legjislacionin e instrumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu në kuadër të këtij trajnimi u elaborua edhe legjislacioni vendor, në veçanti Ligji për Azilin i Kosovës si dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë. Në këtë aspekt u shtjelluan të drejtat e azilantit sipas legjislacionit vendor, procedura e trajtimit të kërkesës për azilin dhe kushtet për pezullimin e kësaj procedure si dhe pushimi i të drejtës për azil.

Dilemat dhe pyetjet gjatë trajnimit u adresuan përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, si dhe punës në grupe të pjesëmarrësve, duke u bazuar në raste dhe duke përdorur shembuj konkret nga praktika gjyqësore aktuale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor dhe të Apelit, prokurorë të nivelit themelor, zyrtarë nga Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe një zyrtar nga Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas.



Kundërvajtjet nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike, (neni 4, 5 dhe 16 i Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike)

Me 29 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka organizuar trajnimin me temë “Kundërvajtjet nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike, (neni 4, 5 dhe 16 i Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike)”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve nga lëmi i rendit dhe qetësisë publike, si të dallojnë vendin publik nga ai jo publik duke e identifikuar veprimin inkriminues, si të përkufizojnë veprimin e sjelljes arrogante të sulmit verbal dhe mospërfilljen e urdhrave të ligjshëm, në mënyrë që t'i aplikojnë drejtë dispozitat sipas Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike.

Trajnimi u fokusua në elaborimin e hollësishëm të çështjeve që kanë të bëjnë me dilemat që paraqiten në praktikë lidhur me:

Kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike, Sjellja arrogante dhe sulmi verbal, Mosveprimi sipas urdhrimit të personit të autorizuar zyrtar sipas LRQP-së, Mosveprimi sipas urdhrimit të personit të autorizuar zyrtar në lëminë e komunikacionit rrugor, si dhe Ndëshkimet për kryerësit e kundërvajtjeve - prishje e rendit dhe qetësisë publike.

Pjesëmarrësve në këtë trajnim përmes diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik, iu ofruan alternativa të ndryshme për paqartësitë dhe vështirësitë e hasura gjatë punës së tyre në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e nivelit themelor - divizioni për kundërvajtje, nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave - Sesioni I

Më datën 29 dhe 30 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e parë të trajnimit me temën “Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave”.

Ky trajnim kishte për synim avancimin e njohurive të pjesëmarrësve lidhur me teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave, mbledhja e informatave, format e shpëlarjes së parave, metodat e zbulimit të transaksioneve, parandalimin e shpëlarjes së parave dhe teknikat e hulumtimit si dhe planifikimi për informata e shpëlarjes së parasë në kuadër të Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës.

Seanca e trajnimit u nda në dy pjesë, në sesionin e parë u elaborua përdorimi i inteligjencës dhe parandalimi i shpëlarjes së parasë, procesi i grumbullimit dhe planifikimit të informatave për shpëlarjen e parave NJIF-s, natyra e rastit, analiza e raportit, adresimi i

kërkesave, menaxhimi i rrezikut, si kuptohet kriminaliteti dhe identifikimi i kryerësve të veprave penale, dhe si bëhet identifikim i kriminit të supozuar.

Në sesionin e dytë u elaborua mënyra e përgatitjes së materialeve lidhur me masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit për zbulimin e shpëlarjes së parave, llojet, kushtet, personat kompetent për të lëshuar këto masa, përmbajtja dhe kohëzgjatja e urdhrave për lëshim të masave, ndihma e organeve tjera për zbatimin e këtyre masave, mënyra e dorëzimit të shkresave si dhe raportet tek palët lidhur me këto masa në procedurë.

Trajnimi u zhvillua në formë interaktive dhe me një rast ku u diskutua rreth sfidave në praktikë dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët hasin gjatë punës së tyre.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të niveleve të ndryshme.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Aktivitetet e realizuara në PTF– për prokurorët e sapo emëruar

Akademia e Drejtësisë, gjatë muajit shtator, ka realizuar aktivitete në kuadër të PTF-së, për prokurorët e sapoemëruar të shtetit, ashtu siç ishin planifikuar me program.

Komponenta e trajnimit teorik, për këtë periudhë, është përmbushur duke realizuar aktivitete si në vijim: në kuadër të nën-modulit “Marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave” është realizuar një (1) sesion trajnues; në kuadër të nën-modulit “Etikë profesionale” janë realizuar shtat (7) sesione trajnuese, përmes së cilave janë trajtuar: historia e Kodeve të Etikës, veprimtaritë gjyqësore dhe jo gjyqësore të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë, përgjegjësitë gjyqësore dhe administrative, pavarësia – përmbajtja dhe vlera juridike e parimit të pavarësisë – influenza e ushtruar nga ekzekutivi dhe legjislativi, paanshmëria dhe parimet e përgjithshme të etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë. Në kuadër të nën-modulit “Shqyrtimi fillestar, i dytë dhe shqyrtimi kryesor” janë realizuar katër (4)

trajnuese, ku janë trajtuar: shqyrtimi fillestar, marrëveshja për pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqiptimi i dënimit, kundërshtimi i provave, kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe shqyrtimi i dytë, sshqyrtimi gjyqësor dhe përgatitjet për shqyrtim gjyqësor si dhe rrrjedha e shqyrtimit gjyqësor. Në kuadër të nën-modulit “Hetimi i krimeve financiare” janë realizuar 2 sesione trajnuese.

Pjesë e aktiviteteve të realizuara në këtë periudhë, ishin edhe vizitat e realizuara në institucionet jo-gjyqësore. Në këtë kuadër, janë realizuar dy (2) të tilla, duke vizituar në këtë formë institucionin Rregullativ të Prokurimit Publik si dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ndërsa në kuadër të trajnimit praktik, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse konform orarit të përcaktuar me program.



Trajnimi praktik në Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Më 20 shtator 2017, në kuadër të vizitave në institucionet jo-gjyqësore, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ka realizuar trajnim/vizitë me prokurorët e sapoemëruar në këtë institucion.

Trajnimi/vizita në AKP kishte për qëllim që prokurorët e sapoemëruar, të fitojnë informata të përgjithshme për rolin, mandatin dhe strukturën organizative të këtij institucioni.

Fillimisht, në kuadër të kësaj vizite/trajnimi, u elaborua mandati, roli dhe përgjegjësia e AKP-së në proceset ligjore të privatizimit të pronës së ndërmarrjeve shoqërore, si dhe sfidat kryesore me të cilat ajo ballafaqohet aktualisht në përmbushje të mandatit dhe obligimeve të saj ligjore. Me tej u pasqyrua struktura

organizative e AKP-së, përfshirë edhe zyrat regionale, të cilat janë nën menaxhimin e saj, procesi i vendimmarrjes në AKP dhe mandati i Bordit të Drejtorëve, si instanca kryesore vendimmarrëse. Në këtë kuadër, u trajtuan edhe komponenta e shitjes së asetëve, dhe likuidimit të ndërmarrjeve si procese operative në AKP.

Prokurorët e sapoemëruar, kishin hapësirë të mjaftueshme për të ngritur dhe diskutuar çështje me interes, të cilat u përcillen me diskutime të përbashkëta mes tyre dhe zyrtarëve të AKP-së.

Përfitues të trajnimit/vizitës ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VI në PTF.



Trajnim i mentorëve në Programin për Trajnim Fillestar

Më 28 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me projektin e binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme reformës për arsimim ligjor”, ka realizuar trajnim për mentorët, e fushës penale, të cilët janë përcaktuar si mentorë për gjyqtarët e sapoemëruar.

Trajnimi kishte për qëllim që mentorët të familjarizohen me metodat dhe teknikat e mentorimit, rolin dhe detyrat e tyre si mentorë, si dhe format adekuate të qasjes së tyre në raport me gjyqtarët e sapoemëruar.

Fillimisht në kuadër të këtij trajnimi, u prezantua struktura e Programit të Trajnimit Fillestar, me theks në pjesën praktike të tij, rregullat dhe standardet që përcakton Doracaku për Mentor, mënyra e organizimit dhe zbatimit të këtij procesi, si dhe roli dhe detyrat e mentorëve në raport me gjyqtarët e

sapoemëruar dhe Akademinë e Drejtësisë.

Më tej, më në detaje, u elaborua komponenta e mentorimit si proces, detyrat dhe përgjegjësitë e mentorëve në asistimin e gjyqtarëve të sapoemëruar, mënyrat dhe praktikat më të mira se si të bartin njohuritë profesionale dhe përvojat e tyre praktike tek gjyqtarët nën mentorimin e tyre. Po ashtu, në kuadër të këtij trajnimi u shtjelluan parimet themelore për menaxhimin e rrjedhës së rasteve, dhe u prezantuan praktikat më të mira të menaxhimit të lëndëve me qëllim që ato të barten tek gjyqtarët e sapoemëruar.

Mentorët janë njoftuar me të gjitha informatat dhe pajisur me dokumentet e nevojshme që hyn në kuadër të PTF-së, siç janë: Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar, Programi i Trajnimit Fillestar, Doracaku për mentor, etj.



Fillimi zyrtar i Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar

Më 29 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë, zyrtarisht ka filluar Programin e Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar, duke realizuar takimin e parë me gjyqtarët e sapoemëruar.

Fillimisht, gjyqtarëve të sapoemëruar, iu drejtua U.D Drejtori i Akademisë së Drejtësisë, z. Besim Morina, i cili i uroj gjyqtarët e ri për emërimin e tyre, duke ju dëshiruar suksese në punën e tyre të re. z. Morina i njoftoj gjyqtarët e ri me rolin dhe rëndësinë që ka trajnimi fillestar, për ngritjen e shkathtësive profesionale dhe praktike me qëllim të përgatitjes së tyre adekuate për të ushtruar funksionin e gjyqtarit. Më tej z. Morina, në pika të shkurta elaboroi strukturën e PTF-së, mënyrën e organizimit dhe realizimit të tij, si të pjesës teorike, po ashtu edhe pjesës praktike, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me këtë program. Po ashtu, ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të Akademisë së Drejtësisë, për mbështetje të vazhdueshme për gjyqtarët e sapoemëruar, në mënyrë që trajnimi fillestar të realizohet në mënyrën më të mirë.

Ndërsa, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të

Kosovës, z. Nehat Idrizi, shprehu mbështetjen e KGJK-së në drejtim të gjyqtarëve të sapoemëruar, duke i inkurajuar për një përkushtim dhe angazhim maksimal gjatë trajnimit fillestar, duke potencuar rëndësinë e këtij trajnimi, në përgatitjen adekuate të tyre që të ushtrojnë në mënyrë të drejtë dhe profesionale funksionet e gjyqtarit. Gjithashtu z. Idrizi i njoftoi gjyqtarët e sapoemëruar me pritjet që ka KGJK, nga këta gjyqtarë si dhe nevojën e ngritjes së kapaciteteve profesionale të tyre me qëllim të ngritjes profesionale të gjyqësorit dhe rritjen e besimit të publikut, si dhe ofroj mbështetje edhe për Akademinë e Drejtësisë, në drejtim të realizimit të suksesshëm të trajnimit fillestar.

Gjyqtarët e sapoemëruar, janë njoftuar me të gjitha informatat dhe dokumentet e nevojshme që hyn në kuadër të PTF-së, siç janë: Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar, Programi i Trajnimit Fillestar, Doracakut për mentor, kalendari trajnues etj. Trajnimin fillestar do ta ndjekin 49 gjyqtarë të sapoemëruar.



Aktivitetet për stafin administrative të gjykatave dhe prokurorive

Menaxhimi i administratës së gjykatave dhe prokurorive

Me 28 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ-it, ka realizuar trajnimin për menaxhmentin e administratës së gjykatave dhe prokurorive me temë “Menaxhimi i administratës së gjykatave dhe prokurorive”.

Objektivi kryesor i këtij trajnimi ishte të ofrojë qasje të barabartë dhe kushte të përshtatshme për rritjen e kualifikimit profesional dhe aftësive praktike të menaxhmentit të administratës së gjykatave dhe prokurorive, në drejtim të fuqizimit të administratës së gjykatave dhe prokurorive, sipas standardeve dhe parimeve profesionale të transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit.

Gjatë këtij trajnimi u theksua roli i rëndësishëm në menaxhimin e administratës, aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të udhëhequr proceset brenda sistemit, për të zhvilluar plane dhe për të ndërmarrë veprime konkrete në formimin e metodave dhe teknikave të reja përmes të cilave mund të arrihet administrimi i gjykatave dhe prokurorive.

Në veçanti u trajtuan çështjet që kanë të bëjnë me parimet dhe standardet për menaxhim të mire, stilet e menaxhimit, roli i administratoreve të gjykatave dhe prokurorive për zbatimin e planeve dhe politikave strategjike, karakteristika kryesore të lidërshiptit, ndërtimi i ekipit dhe zgjidhja e problemeve, menaxhimi i kohës, si dhe menaxhimi i burimeve njerëzore si element që fuqizon punën dhe kontribuon në efikasitetin e gjykatës/prokurorisë.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në teori dhe diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore, si dhe punë në grupe e pjesëmarrësve.

Përfitues të trajnimit ishin administratorët, ndihmës administratorët e gjykatave dhe prokurorive si dhe zyrtarët për personel.



Aktivitetet tjera

Trajnimi fillestar i bazuar në lëndë – Elaborim të Doracakut për trajnim të bazuar në lëndë

Më dt. 21 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit – Mbështetje e mëtejme e reformës për arsimim ligjor, ka realizuar një tryezë diskutimesh me temën “ Trajnimi fillestar i bazuar në lëndë – Elaborimi i Doracakut për trajnim të bazuar në lëndë’.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte të sqaroj në mënyrë të hollësishme modelin didaktik për elaborimin e moduleve për trajnim duke u bazuar në të mësuarin efektiv me pune grupore përmes lëndëve reale.

Në kuadër të kësaj tryeze Akademia e Drejtësisë dhe ekspertët e binjakëzimit janë pajtuar se një model trajnimi i bazuar në raste do ishte qasje e dobishme dhe zbatimi i kësaj metodologjie do të mbështesë gjithashtu të mësuarit vetëdrejtues për gjyqtarët dhe prokuroret e sapo emëruar. Andaj, të dy palët konfirmuan nevojën e hartimit të një doracaku për trajnim të bazuar në lëndë.

Në fokus të kësaj tryeze ishte edhe mënyra e përzgjedhjes së lëndës praktike/reale, shkurtimi

i lëndës për tu prezantuar gjatë trajnimit fillestar, strukturimi i lëndës në module të ndryshme mësimore, gjetja e pyetjeve të rëndësishme dhe didaktika për përzgjedhjen nga të trajnuarit në secilin nivel, si dhe krijimi i mundësisë së pjesëmarrësve në trajnim që të prezantojnë rezultatet.

Gjatë kësaj tryeze po ashtu janë planifikuar edhe aktivitete e radhës që do të realizohen me qëllim të hartimit të një doracaku të bazuar në lëndë. Po ashtu janë shpërndarë detyrat për grupin punues dhe është koordinuar puna e mëtutjeshme.


Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnues të Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokuroreëve, ekspertët të tjerë të angazhuar nga Projekti i Binjakëzimit, dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë.



Punëtorja për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Më 26-27 shtator 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ realizoi “Punëtorinë për hartimin e programit trajnues për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte përcaktimi i



strukturës së moduleve të propozuara që të jenë pjesë e programit trajnues për vitin 2018, si dhe hartimi i koncept dokumenteve të këtyre moduleve trajnuese, të cilat kanë dal si rezultat i procesit të vlerësimit të nevojave i realizuar nga Projekti i Binjakëzimit i cili mbështet Akademinë e Drejtësisë si dhe Akademia në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës e mbështetur edhe nga partnerët ndërkombëtar.

Gjatë punëtorisë fillimisht janë analizuar propozimet dhe rekomandimet të cilat kanë dalë si rezultat i zhvillimit të mekanizmave për vlerësimin të nevojave dhe mbi bazën e tyre është vendos struktura e Programit Trajnues për vitin 2018 për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive.

Bazuar në strukturën e përcaktuar për programin trajnues është hartuar koncepti i secilit modul dhe nën modul, ku përfshihen: qëllimi i trajnimit, evidentohen dilemat dhe përshkruhet qasja në adresimin e këtyre dilemave gjatë trajnimit, gjithashtu koncepti përmban edhe objektivat e trajnimit, përmbajtjen, metodologjinë për realizimin e trajnimit, përfituesit dhe kohëzgjatja e trajnimit.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnues të Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ekspertë të tjera nga fusha relevante, përfaqësues të GIZ-it, Projektit të Binjakëzimit, Programit për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP) dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**